REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 064/22 Dt. 19.04.2022

PRIZREN

AMKMK

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
Agjencia per Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosoves
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo
Nr/Br/No 207/04/22 Nr.faq-Br.strana 4
Data/Datum/Date 15/04/2022
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës**
**Agencija za Upravlanje Memorialnih Komleksa Kosova**
**Agency for the Menagment of Memorial Complexes of Kosovo**

**Komuna e Prizrenit / Opština Prizren / Prizren Belediyesi**

---

# MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT – **Memoriali për Martirët e Krushës së Vogël, në kuadër të Drejtorisë së Administratës – Komuna e Prizrenit.**

**Palët Nënshkruese:**

**Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosoves – përfaqësuar nga Drejtori i përgjithshëm, z. Bislim Zogaj**

**dhe**

**Komuna e Prizrenit – përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj**

**Neni 1**
**Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori i përgjithshëm z. Bislim Zogaj dhe në mes të Komunës së Prizrenit, përfaqësuar nga kryetari i Komunes z. Shaqir Totaj, me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

**"Memoriali për Martirët e Krushës së Vogël" në Komunën e Prizrenit.**

## Neni 2

## Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

2.1. Projekti për "Memoriali i Martirëve të Krushës së Vogël" në Komunën e Prizrenit, sipas kodit 18632, të paraparë sipas planit buxhetor të Agjencisë për vitin 2022.

2.2. Agjenica për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerë prej 100,000.00 Euro për vitin 2022 , ndërsa

3.3. Komuna e Prizrenit është duke financuar këtë projekt në vlerë prej 203,961.32 Euro, ku shuma prej 100.000.00 Euro është paguar në vitin 2021, ndërsa pjesa tjetër prej 3,961.32 Euro do të financohet nga Komuna për vitin 2022

## Neni 3

## Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale

3.1 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale zoton mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshjeje dhe në kopje të zotimin e sjellë në Komunë të Prizrenit për realizimin e kontratës, sipas Marrëveshjes.

3.2 Pagesa për financimin e projektit **Memoriali për Martirët e Krushës së Vogël**" nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale do të bëhet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të organit mbikqyrës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Prizrenit.

3.3. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale mundet të caktojë një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit në fjalë, i cili do t'i raportojë Agjencisë.

## Neni 4
## Obligimet e Komunës

4.1. Komuna e Prizrenit për projektin "**Memoriali për Martirët e Krushës së Vogël**" ka zhvilluar procedurat e prokurimit për procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies dhe nënshkrimit së kontratës.

4.2. Komuna emëron Menaxherin/Organin mbikqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

4.3. Komuna është e obliguar të njoftojë Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për rrjedhat e realizimit të projektit.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e Mërrëveshjes**

5.1. Marrëveshja e lidhur në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe në mes të Komunës së Prizrenit, përfundon me përfundimin e projektit.

5.2. Pas përfndimit të realizimit, projekti regjistrohet si aset i Komunës së Prizrenit.

**Neni 6**
**Ndryshimet dhe Ndërprerja e Marrëveshjes**

6.1 Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast se kontesti eventual apo paqartësi në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike.

6.2 Me pëlqimin e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Kryetarit të Komunës së Prizrenit kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet.

**Neni 7**
7.1. Kjo marrëveshje partneriteti është përpiluar në 4 ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

**Neni 8**
**Hyrja në fuqi**
8.1. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**PALËT NË MARRËVESHJE**

| | |
|---|---|
| **Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale** | **Komuna e Prizrenit** |
| **z. Bislim Zogaj** | **z. Shaqir Totaj** |
| **Drejtor i AMKMK-së** | **Kryetar i Komunës** |

*Datë: 12.04.2022*
*Prishtinë*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

**Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të**
Agencija za Upravlanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Menagement of Memorial of the Complexes of Kosovo

**Komuna e Prizrenit / Opština Prizren / Prizren Belediyesi**

---

# MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

PER FINANCIMIN E PROJEKTIT – **Memoriali për martirët e Krushës së Vogël, në Drejtorin e Administratës – Komuna e Prizrenit.**

## Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale - përfaqësuar nga Drejtori Bislim ZOGAJ

dhe

Komuna e Prizrenit - përfaqësuar nga Mytaher HASKUKA - Kryetar i Komunës.

**Neni 1**
**Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, përfaqësuar nga Drejtori Bislim Zogaj, dhe në mes të Komunës së Prizrenit, përfaqësuar nga prof.dr.Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit, me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

**" Memoriali për martirët e Krushës së Vogël " në Komunën e Prizrenit "**

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo
Nr./Br./No 52/09/21 Nr.faq./Br.str./No.pg. 3
Data/Datum/Date 02/09/2021
PRISHTINË · PRIŠTINA · PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 300/21 Dt. 30.08.2021

## Neni 2

## Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

2.1. Projekti për "Memoriali i martirëve te Krushes së Vogel " në Komunën e Prizrenit", sipas kodit 18632, të paraparë sipas planit buxhetor të Agjensionit.

2.2. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerë prej 50,000.00 Euro.

2.3. Komuna e Prizrenit financon këtë projekt në vlerën prej 150,000.00 Euro, për vitin 2021

## Neni 3

## Obligimet e Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale

3.1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale zoton mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e sjellë në Komunë të Prizrenit për realizimin e kontratës, sipas Marrëveshjes.

3.2. Pagesa për financimin e projektit **Memoriali për martirët e Krushës së Vogël** nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale do të bëhet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të organit mbikqyrës dhe Menagjerit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Prizerenit.

3.4. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale mundet të cakton një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit "Memoriali për martirët e Krushës së Vogël " i cili do t'i raportojë Agjencisë.

## Neni 4

## Obligimet e Komunës

4.1. Komuna e Prizerenit obligohet që për projektin **Memoriali për martirët e Krushës së Vogël.** të zhvilloj procedurat e prokurimit për procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

4.3. Komuna emëron Menaxherin/ Organin mbikqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

4.4. Komuna është e obliguar të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për rrjedhat e realizimit të projektit.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

5.1. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Komuna e Prizerenit përfundon me përfundimin e projektit.

5.2.. Pas perfundimit të realizimit, projekri regjistrohet si aset i Komunes së Prizerenit.

**Neni 6**

**Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

6.1. Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësi në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike.

6.2. Me pëlqim të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Kryetarit të Komunës së Prizerenit kjo marrëveshje mundë të ndryshohet dhe të plotësohet.

**Neni 7**

Kjo marrëveshje partneriteti është përpiluarë në 4 ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

**Neni 8**
**Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj

**PALËT NË MARRËVESHJE**

| | |
|---|---|
| **Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale** | **Komuna e Prizrenit** |
| **Beslim ZOGAJ** | **Prof.dr.Mytaher Haskuka** |
| **Drejtor** | **Kryetar i Komunës** |

**Datë: 30/08/2021**
**Prizren**